

KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN & PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

KAPITULLI 23 – GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE TEMA: PREZANTIMI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË 2024-2030

Ministria e Drejtësisë ka përfunduar procesin e draftimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, hartuar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe që përmban objektivat më të rëndësishme dhe rezultatet e pritshme për 7 (shtatë) vitet e ardhshme. Ky dokument i rëndësishëm u hartua me asistencën teknike të Projektit JustAL.

Në Strategjinë e re theksi vendoset tek konsolidimi i kuadrit ligjor dhe qëndrueshmëria e arritjeve të Reformës në Drejtësi në përputhje me *acquis* të BE, eliminimi i backlog-u dhe rritja e efikasitetit, rritja e cilësisë së shërbimeve, duke u përqëndruar gjithashtu dhe në konsolidimin e kuadrit institucional dhe përmirësimin e infrastrukturës së sistemit të drejtësisë dhe forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës.

REKOMANDIME

Mbi ndryshimet ligjore dhe kuadrin institucional

- Është urgjent plotësimi i akteve rregullatore për funksionimin e dy organeve të rëndësishme të sistemit të drejtësisë: Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP), të cilët deri tani kanë operuar pa e pasur një bazë të tillë të plotë ligjore.
- Masat për ndërmjetësimin duhet të jenë më proaktive që të fokusohen jo vetëm në fushatat e informimit dhe ndërgjegjësimit për qytetarët, por dhe sistemi i referimit të gjykatave duhet të intensifikohet dhe të nxisin qytetarët që në rastet kur është e mundur të priren drejt zgjidhjeve alternative me ndërmjetësim.
- Buxheti për ndihmën juridike falas, rekomandohet që të rishikohet në mënyrë që të jetë në përputhje me nevojat dhe kërkesat që këto kategori personash që përfitojnë nga ndihma juridike falas realisht kanë, duke parashikuar dhe një analizë të mirëfilltë të situatës së këtyre grupeve përfituese.

Mbi procedurat dhe efektivitetin e institucioneve të drejtësisë

- Duhet riparë masa që parashikon që procesi i *vettingut* do të ketë arritur në 80% të vlerësimeve të magistratëve. Ky proces duhet të përfundojë sa më parë dhe sa më shpejt.
- Me shqetësim është vërejtur dhe fakti që prokuroritë kanë pushuar apo nuk e kanë filluar fare ndjekjen e çështjeve ndaj gjyqtarëve apo

prokurorëve duke dhënë arsytetime të pabazuara pse kanë vepruar në këtë mënyrë. Kjo ka bërë që shumë prej këtyre rasteve të ketë ndodhur dhe kalimi i afatit të ndjekjes penale. Kjo çështje duhet parë me prioritet.

- Si një zhvillim i kohëve të fundit, gjithashtu bazuar dhe në hovin që ka marrë dhe inteligjenca artificiale sugjerohet që dixhitalizimi për sistemin e gjykatave të jetë një element me vëmendje të shtuar për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve online (për të shmangur kostot ekonomike apo kursyer në kohë) por edhe të dhe të fillojnë përpjekje për të avancuar më tej ndaj mundësisë për realizimin e seancave gjyqësore online.
- Në kuadër të dixhitalizimit rekomandohet që Sistemi Online i Menaxhimit të Çështjeve (Case Management System) të ndërlidhet me sa më shumë baza të tjera të dhënash me informacione relevante që lehtësojnë marrjen dhe shkëmbimin e informacionit midis sistemeve.

Mbi bashkëpunimin me aktorët e shoqërisë civile

- Është i nevojshëm dhënia e *feedback* dhe përgjigjes pas dhënies së rekomandimeve dhe sugjerimeve, që procesi të jetë sa më transparent dhe ndërveprues, duke ofruar informacion se cilat rekomandime janë marrë ose jo në konsideratë, dhe kur është e mundshme dhe duke ofruar arsyetimet përkatëse.
- Bashkëpunimi më shoqërinë civile të jetë e strukturuar dhe e formalizuar që të dali më qartë roli dhe përfshirja e aktorëve të shoqërisë civile, çfarë pritët prej tyre dhe si mund të kontribuojnë konkretisht. Në këtë drejtim duhet pasur në vëmendje dhe kombinimin e aktiviteteve të Tryezës së Kapitullit 23 të Platformës së Partneritetit, por dhe rrjeteve dhe

platformave të tjera të ngritura nga vet aktorët e shoqërisë civile me fokus çështjet e sistemit të drejtësisë.

- OSHC-të duhet dhe mund të përfshihen dhe si *watchdog* për monitorimin e Strategjisë, në ato fusha dhe çështje që ata kanë ekspertizë dhe mund të ofrojnë vlerësime dhe analizë të sakta e të detajuara mbi masat dhe indikatorët e strategjisë.
- Këshillohet që të ketë një komunikim direkt të lehtësuar nga Ministria e Drejtësisë mes aktorëve të shoqërisë civile dhe institucioneve të Drejtësisë apo Ministrisë për të informuar apo paralajmëruar gjatë monitorimit apo vlerësimit të Strategjisë, por edhe mbi mundësitë e aksioneve dhe aktiviteteve të përbashkëta.

Mbi zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë

- Rekomandohet që të ketë një koordinim sa më të mirë mes Ministrisë dhe Institucioneve të drejtësisë për zbatimin e masave të parashikuara në Strategji, ku këto institucione mund të përgatisin plane më të detajuara veprimi për ato pika dhe çështje që janë të përfshira drejtpërdrejt. Kjo do të lehtësonte dhe procesin monitorues por dhe koordinimin ndërinstitutional.
- Rekomandohet gjithashtu, që afatet të vendosen jo vetëm për aktivitetet por dhe për masat e parashikuara në Strategji, pasi kjo do të lehtësonte procesin monitorues dhe do të jepte një pamje më të artë të arritjeve dhe problematikave. Këto afate do të ndihmonin si ministrinë dhe institucionet përgjegjëse për monitorimin, por edhe shoqërinë civile që të monitoronin këto rezultate.

- Rekomandohet që të parashikohet forcimi i mekanizmave dhe instrumenteve monitoruese ekzistuese, por dhe të përdoren metodologji të reja dhe në bashkëpunim me shoqërinë civile apo akademinë e universitetet për monitorimin e strategjisë, masave të parashikuara dhe arritjes së objektivave. Një vëmendje e veçantë për tu monitoruar dhe vlerësuar duhet ti kushtohet:
 - pjesës së rritjes së besimit të qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të shërbimit të drejtësisë për qytetarët duke qenë që janë dy elemente që janë të ndërlidhura.
 - ndikimit që strategjia gjatë zbatimit mund të ketë mbi barazinë gjinore duke përgatitur dhe analiza sipas indikatorëve bazuar në kërkesat specifike të grupeve gjinore
 - ndikimit që Harta e Re Gjyqësore do të ketë në aksesin në drejtësi sidomos për grupet vulnerabël (qofshin pozitive apo negative)
- Për një vlerësim sa më të qartë por edhe kuptueshmëri të procesit sesi po zbatohet strategjia rekomandohet që indikatorët të mos lidhen vetëm me objektivat, por edhe me masat konkrete të veprimit. Në këtë mënyrë, kjo ndërlidhje ndihmon për të kuptuar më saktë në cilat fusha ka një progres dhe janë në realizim, dhe cilat shfaqin problematika dhe duhet një vëmendje më e madhe.